



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 3: Statistikat Ekonomike**

# **Indeksi i Kostos të Ndërtimit TM1 2018**



## **P a r a t h ë n i e**

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka filluar të publikojë Indeksin e Kostos të Ndërtimit (IKN) për herë të parë në vend më 27 Mars të vitit 2014.

Indeksit i Kostos të Ndërtimit (IKN) fillimisht në vend është publikuar me bazë tremujore TM1 2013=100. Ndërsa nga tremujori i parë (TM1) 2016 me rekomandimet e eksperteve nga Statistika e Suedisë dhe Agjencioni Suedez i Zhvillimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SIDA), Indeksi i Kostos të Ndërtimit (IKN) është kalkuluar me vitin bazë 2015=100. Me këtë bazë janë ri-kalkuluar të gjitha seritë kohore të IKN në vend.

Ky publikim përmban: tabelën me Indeksin e Kostos të Ndërtimit në baza tre mujore TM1 2013-TM1 2018 me ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje, tabelën me IKN për ndërtesat shumëkatëshe sipas kategorive (TM1 2013-TM1 2018) dhe tabelën me pesha specifike TM1 2018 me ndryshimet tremujore dhe vjetore ( TM1 2018/TM42017 dhe TM12018/TM1 2017 sipas kategorive të kostove.

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe ato të dërgohen në adresën elektronike: [ekonomic@ks-gov.net](mailto:ekonomic@ks-gov.net)

Ky publikim është përgatitur nga:

Ilir T. Berisha - Drejtor i Departamentit

Ibish Asllani - Shef i Divizionit

Arlinda Mataj - Zyrtare e lartë

Qershor, 2018

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së  
Isa Krasniqi

## **Simbolet dhe Shkurtesat**

ASK Agjencia e Statistikave të Kosovës

IKN Indeksi I kostos të ndërtimit

SIDA Agjencioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar

: Shifra nuk është disponibël

- Nuk aplikohet

% Përqindje

## Përmbajtja

Faqe

Indeksi i Kostos të Ndërtimit (IKN) për tremujorin e parë 2018.....	5
Tab.1: Indeksi i Kostos të Ndërtimit (IKN) TM1 2013-TM1 2018 (2015=100), ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje .....	6
Grafiku 1 : Zhvillimi I IKN, TM1 2013-TM1 2018 (2015=100), sipas tremujoreve.....	7
Tab. 2 Indeksi I Kostos të Ndërtimit për ndërtesat shumëkatëshe sipas kategorive (TM1 2013-TM1 2018) .....	8
Tabela 3: Peshat, IKN-it TM1 2018 (2015=100), ndryshimet tremujore dhe vjetore sipas kategorive të kostove .....	8
Metodologjia IKN .....	9

## **Indeksi i Kostos të Ndërtimit (IKN) për tremujorin e parë 2018**

Indeksi i tërësishëm i Kostos të Ndërtimit në Kosovë (IKN) pati një rënie për (- 0.7 %) në tremujorin e parë TM1 2018 krahasuar me TM4 2017. Krahasuar me TM1 2017 Indeksi i Kostos të Ndërtimit kishte ngritje me një mesatare prej (0.6 %) .

### **Tremujori i parë 2018- Tremujori i katër 2017 - 0.7 %**

Indeksi i tërësishëm i Kostos të Ndërtimit në Kosovë (IKN) pati një rënie për ( - 0.7 % ) në tremujorin e parë TM1 2018 krahasuar me TM4 2017. Rënie më të madhe kishin kategoria energjia (- 4.9 %) dhe kategoria materialet me (-1.0%) . Një ngritje e lehtë u vërejt te kategoria makineritë ( 0.7 %) dhe kostot e tjera (0.5%).


### **Tremujori i parë 2017 - Tremujori i parë 2018 0.6 %**

Indeksi i tërësishëm i Kostos të Ndërtimit në Kosovë (IKN) u ngrit për (0.6 %) në TM1 2018 krahasuar me TM1 2017 . Ngritja e indeksit kryesisht u vërejt të kategoria materialet (1.0 %). Ndërsa kategoritë që kishin rënie janë: kategoria e makinerisë (-2.2%) dhe energjia (-1.4%).

Tab.1: Indeksi i Kostos të Ndërtimit (IKN) TM1 2013-TM1 2018 (2015=100), ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje

Viti	Periudhat	Indeksi (2015=100)	Ndryshimet tremujore në %	Ndryshimet vjetore në përqindje %
2013	TM1	99.5	:	:
	TM2	99.6	0.1	:
	TM3	99.7	0.1	:
	TM4	99.6	-0.1	:
<b>Mesatarja vjetore 2013</b>		<b>99.6</b>	:	:
2014	TM1	99.8	0.2	0.3
	TM2	99.9	0.1	0.3
	TM3	99.9	0.0	0.2
	TM4	99.9	0.0	0.3
<b>Mesatarja vjetore 2014</b>		<b>99.9</b>	:	<b>0.3</b>
2015	TM1	100.1	0.2	0.3
	TM2	100.4	0.3	0.5
	TM3	100.5	0.1	0.6
	TM4	99.0	-1.5	-0.9
<b>Mesatarja vjetore 2015</b>		<b>100.0</b>	:	<b>0.1</b>
2016	TM1	100.0	1.0	-0.1
	TM2	98.7	-1.3	-1.7
	TM3	98.9	0.2	-1.6
	TM4	99.1	0.2	0.1
<b>Mesatarja vjetore 2016</b>		<b>99.2</b>	:	<b>-0.8</b>
2017	TM1	100.5	1.4	0.5
	TM2	100.6	0.1	1.9
	TM3	101.1	0.5	2.2
	TM4	101.8	0.7	2.7
<b>Mesatarja vjetore 2017</b>		<b>101.0</b>	:	<b>1.8</b>
2018	TM1	101.1	-0.7	0.6

Grafiku 1 : Zhvillimi I IKN, TM1 2013-TM1 2018 (2015=100), sipas tremujoreve



**Tab. 2 Indeksi I Kostos të Ndërtimit për ndërtesat shumëkatëshe sipas kategorive (TM1 2013-TM1 2018)**

2015=100

Kategoria e Kostove												
		1 Materialet (a+b+c)	(a) Materialet ndërtimore	(b) Materialet elektrike	(c) Materialet hidro-sanitare	2 Pagat	3 Makineritë	4 Transporti	5 Energjia	6 Kostot e tjera	Gjithsej (1+2+3+4+5+6)	
<b>Peshat</b>		<b>69.8</b>	60.4	5.1	4.3	<b>16.4</b>	<b>5.9</b>	<b>3.8</b>	<b>1.4</b>	<b>2.7</b>	<b>100.0</b>	
<b>Periudhat</b>	2013	TM1	100.4	100.7	96.4	99.8	96.8	95.5	105.3	86.2	100.8	99.5
		TM2	100.6	101.0	96.7	99.5	96.8	95.5	105.3	81.8	99.8	99.6
		TM3	100.8	101.3	95.8	99.5	96.8	95.5	105.3	81.8	99.5	99.7
		TM4	100.5	101.0	95.7	99.4	96.8	95.5	105.3	88.9	100.3	99.6
	2014	TM1	100.7	101.4	95.7	97.8	96.8	96.1	105.3	89.0	101.0	99.8
		TM2	100.8	101.3	97.4	97.8	96.8	98.4	105.3	86.4	100.2	99.9
		TM3	100.7	101.2	97.7	97.8	96.8	98.4	105.3	87.2	100.5	99.9
		TM4	100.3	100.6	98.7	97.8	97.0	99.8	105.3	99.4	100.4	99.9
	2015	TM1	100.5	100.6	100.4	99.5	97.0	99.8	105.3	99.4	100.6	100.1
		TM2	100.1	100.2	99.2	99.5	101.0	99.8	105.3	100.0	99.8	100.4
		TM3	100.2	100.2	100.9	100.5	101.0	100.1	105.3	100.1	99.6	100.5
		TM4	99.2	99.0	99.5	100.5	101.0	100.2	84.2	100.4	100.0	99.0
	2016	TM1	100.4	100.6	97.4	100.5	101.0	102.9	84.2	100.4	100.6	100.0
		TM2	99.3	99.2	98.2	101.4	101.0	103.2	70.2	102.5	99.7	98.7
		TM3	99.5	99.4	98.5	102.1	101.0	103.6	70.2	102.8	99.8	98.9
		TM4	99.6	99.4	100	102.6	101.0	104.4	70.2	101.2	101.1	99.1
	2017	TM1	101.0	100.9	100.6	102.8	101.0	104.3	81.9	101.4	102.3	100.5
		TM2	101.1	100.9	100.1	103.8	101.0	104.3	81.9	104.7	101.6	100.6
		TM3	102.2	101.8	100.1	109.2	101.0	101.4	81.9	102.3	101.5	101.1
		TM4	103.1	102.8	100.4	109.2	101.0	101.3	81.9	105.2	101.8	101.8
2018	TM1	102.0	101.6	101.0	108.9	101.0	102.0	81.9	100	102.3	101.1	

**Tabela 3: Peshat, IKN-it TM1 2018 (2015=100), ndryshimet tremujore dhe vjetore sipas kategorive të kostove**

Kodi	Kategoritë të kostove	Peshat	TM1-2018	TM 1 - 2018	TM 1 - 2018
			2015=100	TM 4 - 2017	TM 1 - 2017
<b>1</b>	<b>Materialet (a+b+c)</b>	<b>69.8</b>	<b>102.0</b>	<b>-1.0</b>	<b>1.0</b>
	a. Materialet ndërtimore	60.4	101.6	-1.2	0.7
	b. Materialet elektrike	5.1	101.0	0.6	0.5
	c. Materialet hidro-sanitare	4.3	108.9	-0.3	5.9
<b>2</b>	<b>Pagat</b>	<b>16.4</b>	<b>101.0</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>
<b>3</b>	<b>Makineritë</b>	<b>5.9</b>	<b>102.0</b>	<b>0.7</b>	<b>-2.2</b>
<b>4</b>	<b>Transporti</b>	<b>3.8</b>	<b>81.9</b>	<b>0.0</b>	<b>0.0</b>
<b>5</b>	<b>Energjia</b>	<b>1.4</b>	<b>100.0</b>	<b>-4.9</b>	<b>-1.4</b>
<b>6</b>	<b>Kostot e tjera</b>	<b>2.7</b>	<b>102.3</b>	<b>0.5</b>	<b>0.0</b>
<b>Gjithsej</b>		<b>100.0</b>	<b>101.1</b>	<b>-0.7</b>	<b>0.6</b>



## Metodologjia IKN

### Përshkrimi metodologjik i Indeksit të Kostos së Ndërtimit për ndërtesat shumëkatëshe të banimit

Indeksi i Kostos të Ndërtimit mat zhvillimin e çmimeve të faktorëve të prodhimit të lëndëve të para, të pagave, makinerive, transportit, energjisë dhe kostot e tjera që përdoren në projektet e ndërtimit. Indeksi mat ndryshimin e çmimeve për faktorët individualë të prodhimit dhe i peshon këto në përputhje me një sistem të caktuar të peshimit. Indeksi nuk mat ndryshimet e produktivitetit të tilla si përdorimi më i mirë i materialeve, apo faktorët e tjerë, e as nuk pasqyron marzhat e fitimit.

### Popullsia

Indeksi i Kostos të Ndërtimit është i kufizuar për ndërtesat e sapondërtuara shumëkatëshe, që është lloji më i zakonshëm i projektit të ndërtimit në Kosovë. Indeksi llogaritet për të gjithë Kosovën.

### Kategoritë e Kostos

Indeksi i Kostos të Ndërtimit për banesat shumëkatëshe përfshin gjashtë kategori të kostos si në vijim:

- Materialet
- Pagat
- Makineritë
- Transporti
- Energjia
- Kostot e tjera

### Indeksi model

Nga tremujori i parë i vitit 2016, modeli i indeksit për Indeksin e Kostos të Ndërtimit ka ndryshuar nga indeksi bazë fiks në llojin e indeksit zinxhir me lidhje vjetore të Laspeyerit dhe këto te dhëna janë publikuara me 14.06.2016 në Ueb-faqen e ASK-ës (në publikimin Indeksi i Kostos të Ndërtimit IKN TM1 2016). Arsyeja kryesore për ndryshimin e modelit të indeksit nga indeksi me bazë fikse në indeks të zinxhirit është se kjo mundëson përfshirjen e artikujve të ri ose të fshijë artikujt e vjetër të cilët nuk janë më të rëndësishëm. Arsyeja e dytë është harmonizimi i IKN-së me treguesit e tjerë të çmimeve të prodhuara nga ASK-ja të cilat përdorin modelin e indeksit zinxhir.

Periudha referuese e indeksit referencë (periudha bazë) në të njëjtën kohë është ndryshuar nga tremujori i parë i vitit 2013 me mesataren e vitit 2015 (viti bazë 2015 = 100). Nga qershori i vitit 2016 dhe në vazhdimësi janë të publikuara seritë kohore ne baza tremujore nga muaj janar i vitit 2013 me baze 2015=100.

Indeksi i Laspeyerit është përcaktuar si

$$I^t = \frac{\sum_{i=1}^n P_i^t Q_i^0}{\sum_{i=1}^n P_i^0 Q_i^0} = \sum_{i=1}^n \frac{P_i^0 Q_i^0}{\sum_{i=1}^n P_i^0 Q_i^0} \times \frac{P_i^t}{P_i^0}$$

Ku  $P^0$  dhe  $P^t$  janë çmimi për njësi në periudhën bazë (0) dhe periudha e krahasimit (t), respektivisht, dhe  $Q^0$  është sasia e periudhës bazë. Mbledhja bëhet nëpërmes produkteve n. Në elementin e parë të mësipërm, indeksi shprehet si raporti midis vlerës së mbledhur të sasive të periudhës bazë në periudhën e krahasimit dhe, respektivisht, nivelit të çmimeve të periudhës bazë. Indeksi gjithashtu mund të shprehet, si në elementin e dytë, si mesatare e përafërt e çmimeve të prodhimeve të peshuar me vlerat e periudhës bazë.

Lidhjet e indeksit llogariten me tremujorin aktual  $q$  në vit  $y$  si periudhë e krahasimit dhe me tremujorin e katërt në vitin  $y-1$  si periudhë referuese e çmimeve. Periudha e peshimit është tremujori i parë i vitit 2013. Andaj, lidhja përkufizohet si:

$$I_{y-1,q}^{y,q} = \sum_{s=1}^k \frac{V_s}{\sum_{s=1}^k V_s} \times \frac{I_s^{y,q}}{I_s^{y-1,q}}$$

Ku pesha e vlerës  $V_s$  është vlera e transaksioneve në Tm1 2013 që përfaqësohen nga kostoja e artikullit  $s$ . Mbledhja bëhet nëpërmes artikujve të kostos  $k$ . Indeksi i periudhës së referencës së çmimit për periudhën e krahasimit llogaritet në dy hapa:

$$\frac{I_s^{y,q}}{I_s^{y-1,q}} = \frac{I_s^{y,q}}{I_s^{y,q-1}} \times \frac{I_s^{y,q-1}}{I_s^{y-1,q}}$$

### Llogaritja e indeksit zinxhiror

Numri i indeksit zinxhiror llogaritet për tremujorët dhe tregon nivelin e veçantë të çmimit të tremujorit në krahasim me nivelin e çmimit mesatar në vitin 2015 (2015 = 100).

$$I_{2015}^{y,q} = \frac{100}{\frac{1}{4} \sum_{q=1}^4 I_{2014,q4}^{2015q}} \times \prod_{Y=2015}^{y-1} I_{Y-1,q4}^{Y,q4} \times I_{y-1,q4}^{y,q}$$

### Llogaritja e ndryshimeve

Ndryshimi tremujor llogaritet si:

$$\left[ \left( \frac{CCI_{2015}^{Y,q}}{CCI_{2015}^{Y,q-1}} \right) - 1 \right] * 100 = \text{Ndryshimi i përqindjes në tremujor}$$

Ndryshimi vjetor llogaritet si:

$$\left[ \left( \frac{CCI_{2015}^{Y,q}}{CCI_{2015}^{Y-1,q}} \right) - 1 \right] * 100 = \text{Ndryshimi i përqindjes në vjetor}$$

$CCI_{2015}^{Y,q}$  = Indeksi zinxhiror i kostos së ndërtimit për tremujorin aktual q

$CCI_{2015}^{Y,q-1}$  = Indeksi zinxhiror i kostos së ndërtimit për tremujorin paraprak q-1

$CCI_{2015}^{Y-1,q}$  = Indeksi zinxhiror i kostos së ndërtimit për vitin paraprak y-1 dhe tremujorin q

### Mbledhja e të dhënave

Për materialet e ndërtimit, çmimet mblidhen nga furnizuesit e materialeve të ndërtimit. Furnizuesit kanë të bëjnë drejtpërdrejt me kontraktorin. Për të mbledhur informacionin e çmimeve, një pyetësorë u dërgohet kompanive ku ASK-ja në mënyrë specifike tregon se për çfarë produkti po mblidhen informatat për çmimet. Furnizuesit e dhënave mund të shohin se çfarë çmimi i kanë dorëzuar ASK-së në tremujorin e fundit. ASK kërkon çmimet mesatare që kompanitë i kanë për produktet e tyre çdo tre muaj.

Kostot e pagave mblidhen nga kompanitë ndërtimore.

Për kostot e makinerive, ASK-ja mbledhë çmimet për makinat e vogla që përdoren në sektorin e ndërtimitarisë.

ASK-ja mbledhë çmimet për shërbimet e transportit të materialeve ndërtimore nga disa kompani ndërtimore.

Çmimet grumbullohen përmes stafit të zyrave rajonale të ASK-se në periudha tremujore.

Kalkulimi i Indeksit të kategorisë se **energjisë** bëhet nga të dhënat e Indeksit të Çmimeve të Prodhimit i cili është në përputhshmëri me klasifikimin standard të veprimtarive NACE rev .2, dhe i cili është i bazuar në “ Rregulloren nr. 11/2013 neni 7” , në kuadër të ASK-së.

Te kategoria **kostot e tjera**, kalkulimi i indekseve bëhet nga ecuria e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve konsumit në kuadër të ASK-së.

### **Peshat**

Peshat për Indeksin e Kostos të Ndërtimit bazohen në pyetësonin për kompanitë e ndërtimit. Siç u përmend më lart, peshat janë nga tremujori i parë i vitit 2013.

### **Përdorimi i Indeksit të Kostos të Ndërtimit**

Indeksi i Kostos të Ndërtimit për ndërtesat shumëkatëshe është indikator i rëndësishëm për palët e interesit, si dhe për analizimin e sektorit të ndërtimitarisë. Mund të përdoret edhe si deflator tek llogaritë kombëtare për ndërtimin e ndërtesave të reja shumëkatëshe.

